



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1088/24 Datë: 30/05/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 123-të, mbajtur me datë 20.05.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

### V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Kolegjit UBT dega në Prizren për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
  - *Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji BSc 180 ECTS, me specializimet: 1. Teknologjia e Ushqimit, dhe 2. Të ushqyerit (Nutricion), me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve si në paragrafin I zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Kolegjit UBT dega në Prizren që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegjit UBT dega në Prizren të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimet e bartësve bëhen me vendim nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A R S Y E T I M

Faqe 1 nga 2

Kolegji UBT dega në Prizren kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin/riakreditimin e programeve të studimit me bartësit e programeve si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji BSc 180 ECTS me specializimet: 1. Teknologjia e Ushqimit, dhe 2. Të ushqyerit (Nutricion).</i>	Flutura Ajazi Ilmije Vllasaku Laura Binxhija Gentiana Balaj Veton Haziri

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT dega në Prizren.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji BSc 180 ECTS me specializimet: 1. Teknologjia e Ushqimit, dhe 2. Të ushqyerit (Nutricion),** vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Damir Magdic, Reiner Doluschitz dhe Nadia Manzoni është organizuar më 04.04.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2) dhe Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 123-të të mbajtur më datë 27.03.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegji UBT dega në Prizren dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit UBT dega në Prizren;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë